



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 17 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 15.3 të Ligji nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid 19 në territorin e Republikës së Kosovës, neneve 16 dhe 19 parag. 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-50862/18, Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M **PËR AKTIVIZIMIN E QENDRËS OPERATIVE EMERGJENTE LOKALE**

Neni 1

Aktivizohet Qendra Operative Emergjente Lokale-QOEL në Komunën e Podujevës për shkak të situatës së krijuar nga Pandemia e Corona virusit Covid 19.

Neni 2

Qendra Operative do të jetë në shërbim të qytetarëve 24 orë, 7 ditë në javë, deri në një vendim tjetër.

Neni 3

QOEL punët dhe aktivitetet i ushtron në bashkëpunim dhe koordinim me Komisionin për veprime dhe masa kundër virusit epidemic Covid 19(Shtabi Emergjent) dhe Institucionet përkatëse të nivelit lokal dhe Qendror.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Shtojcë: Lista e anëtarëve të QOEL

Nr. 02-016/01-0075460/21
Podujevë, 01 shtator 2021



Lista e anëtarëve të Qendrës Operative Emergjente – Podujevë

1. Avni Maksuti
2. Enver Cakiqi
3. Shpend Bekteshi
4. Enver Mehana
5. Arsim Mehmeti
6. Kujtim Zhitia
7. Afrim Mulliqi
8. Sami Hoxha
9. Naime Ajeti
10. Fidan Restelica
11. Fidan Salihu
12. Granit Hasani
13. Avni Maloku
14. Ahmet Ahmeti
15. Tahir Mehana
16. Rizah Muqolli
17. Masar Çitaku
18. Venoza Zullufi
19. Rafet Hasani
20. Vahedin Abdullahu
21. Sabedin Namani
22. Blerim Vllasa



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 b) g) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenet 14.2 dhe 15.4 të Ligjit nr. 07/L-006 për parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës, nenet 16 dhe 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18 dhe Vendimin nr.prot.01/32 të datës 28 gusht 2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin e dhe luftimin e pandemisë covid 19, merr këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VEPRIME DHE MASA KUNDËR VIRUSIT EPIDEMIK COVID19 (SHTABI EMERGJENT)

Neni 1

Formohet komisioni i veçantë ad-hoc për ndërmarrjen e veprimeve dhe masave preventive në funksion të parandalimit të përhapjes së virusit epidemik COVID-19, në territorin e Komunës së Podujevës, në përbërje:

- | | |
|---|----------|
| 1. Shpejtim Bulliqi , <i>Kryetari i Komunës</i> , | kryesues |
| 2. Marigona Lahu , <i>Nënkryetare e Komunës</i> , | anëtare |
| 3. Driton Veliu , <i>drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale</i> , | anëtar |
| 4. Ymer Llugaliu , nga <i>Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare - QKMF</i> , | anëtar |
| 5. Bedrie Rama , <i>epidemiologe, në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare</i> , | anëtare |
| 6. Bahri Selimi , <i>drejtor i Drejtorisë së Administratës</i> , | anëtar |
| 7. Fevzi Jetullahu , <i>drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit</i> , | anëtar |
| 8. Bedri Maqastena , <i>drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit</i> , | anëtar |
| 9. Nijazi Jashari , <i>Komandanti i Stacionit të Policisë - Podujevë</i> , | anëtar |
| 10. Avni Fetahu , <i>drejtor i Drejtorisë së Arsimit</i> , | anëtar |
| 11. Mensur Hoti , <i>kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame – Podujevë</i> , | anëtar |
| 12. Vail Shala , <i>Kryqi i Kuq i Kosovës – Sekretar në Degën Podujevë</i> , | anëtar |

Neni 2

Komisioni ndërmerr veprime dhe masat e nevojshme në përputhje me Ligjin për parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës, Vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe me Udhëzimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë lidhur me masat preventive për parandalimin e përhapjes së epidemisë COVID-19.

Neni 3

Vendimi hyn ditën e nënshkrimit, ndërsa shfuqizohet Vendimi për formimin e Komisionit për veprime dhe masa kundër virusit epidemik covid19 (shtabi emergjent) me nr.prot. 02-020/04-0075461/20, dt.11 dhjetor 2020 dhe Vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e përbërjes së Vendimit për formimin e Komisionit për veprimë dhe masa kundër virusit epidemik covid-19 (shtabi emergjent) nr. prot. .02-020/04-0012101/21, dt. 12 shkurt 2021.

U dërgohet:

Anëtarëve të Komisionit dhe mekanizmave relevant të nivelit qendror dhe lokal.

Nr.prot.02-020/04-0075538/21
Podujevë, 01 shtator 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040 dhe nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr. 01-020/01-0050862/18, jep këtë :

AUTORIZIM

Autorizohet z.Bedri Maqastena, Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit që nga data 01.09.2021 deri më 03.09.2021 të nënshkruaj dokumentacionin nga kompetenca dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, derisa znj. Bahrije Shatrolli-Mehmeti, Drejtoreshë e Drejtorisë së cekur të kthehet nga pushimi vjetor.

Nr.02-016/01-0075550/21
Podujevë, 01 shtator 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18 , Kryetari i Komunës, jep:

AUTORIZIM

I.

znj. Mirsime Haxiu, asistente administrative në kuadër të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, autorizohet për nënshkrimin e certifikatave të pronës dhe të deponojë nënshkrimin me qëllim të vulosjes së tyre.

Nënshkrimi i të autorizuarës

II.

Autorizimi jepet për kohë të pacaktuar dhe vlen deri në revokimin apo plotësim ndryshimin e tij.

U dërgohet:

-Të autorizuarës

-Arkivës

Nr.02-020/05-0075955/21
Podujevë, 02 shtator 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040 dhe nenin 61 parag. 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës së Podujevës:

T Ë R H E Q Ë

Autorizimin për ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësiive të udhëheqëses të sektorit për inspektime me nr. prot. 02-020/-05-0031104/21, të datës 07.04.2021, lëshuar znj. Majlinda Statovcit, *inspektore e ndërtimit në Drejtorinë e Inspeksionit*.

Tërheqja e autorizimit bëhet për shkak të nevojës së angazhimit dhe përqendrimit të të përmendurës në punë dhe detyra të punës që ka sipas sistematizimit të vendit përkatës të punës.

U dërgohet:

Majlinda Statovcit
Arkivës
Zyrës së Personelit

Nr. 02-020/05-0076018/21
Podujevë, 02 shtator 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 8 dhe 15 të Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400, Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarjen e mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400 dhe Vendimin për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2021 dhe parashikimet buxhetore 2022-2023 nr.01-400/03-0059131/20, dt. 30.09.2020, në rekomandim të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.02-020/04-0002354/21, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, sipas Ftesës publike nr. 12-320/01-0012738/21, dt. 15.02.2021, Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M **PËR PËRKRAHJE TË FERMERËVE-BLETARËVE NË KOMUNËN E** **PODUJEVËS**

Neni 1

Njëqind e pesë (105) fermerë-bletarë nga Komuna e Podujevës përkrahen me nga pesë (5) shoqëri bletësh dhe nga një koshere tre katërshe antivaro, sipas Ftesës publike nr. 12-320/01-0012738/21, dt. 15.02.2021, për realizmin e projektit “Përkrahja me shoqëri bletësh”, në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pylttarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 2

Subvencioni bëhet me qëllim të promovimit dhe zhvillimit të bletarisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Lista e përfituesve sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Zbatimin e Vendimit e bën Drejtoria e Bujqësisë Pylttarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-400/01-0076647/21
Podujevë, 03 shtator 2021



Kryetari i Komunës
Shpetim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 8 dhe 15 të Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400, Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarjen e mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400 dhe Vendimin për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2021 dhe parashikimet buxhetore 2022-2023 nr.01-400/03-0059131/20 , dt. 30.09.2020, Memorandumit të bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit nr.02-016/01-0055359/21 të datës 09.07.2021, në rekomandim të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.02-020/04-0002354/21, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, sipas Ftesës Publike nr.12-320/01-01-0058304/21, dt. 19.07.2021, Kryetari i Komunës, merr:

VENDIM PËR PËRKRAHJEN E FERMERËVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Në kuadër të projektit të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të realizuar në bashkëpunim dhe bashkëfinancim me Organizatën Qatar Charity në cilësinë e donatorit, në kategorinë sipas ftesës publike “Furnizimi i fermerëve me Serra 120 m²” ndahen 15 (pesëmbëdhjetë) Serra ndërsa në kategorinë Shoqëri Bletësh ndahen 6 (gjashtë) Shoqëri Bletësh”, për fermerët përfitues nga Komuna e Podujevës.

Neni 2

Ndarja e serrave dhe shoqërive të bletëve bëhet me qëllim të promovimit dhe zhvillimit të bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Lista e përfituesve sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Zbatimin e Vendimit e bënë Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-400/03-0078226/21
Podujevë, 08 shtator 2021



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Ligjin nr. 04/l-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik dhe nenin 16 të Statutit të Komunës, nr.01-20/01-0050862/18, Kryetari i Komunës merr:

V E N D I M

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN DHE VERIFIKIMIN E PUNËVE LIDHUR ME REALIZIMIN E PROJEKTIT SIPAS KONTRATËS SË PROKURIMIT NR. 615-20-4093-5-2-1

Neni 1

Për vlerësimin dhe verifikimin e punëve të kryera në projektin “Renovimi i hyrjeve dhe korridoreve të objekteve banesore në qytet”, sipas kontratës së prokurimit nr. 615-20-4093-5-2-1, ngritet komisioni në këtë përbërje:

1. Ismet Kadriu, kryesues
2. Musli Kutleshi, anëtar
3. Hanushe Gjata, anëtare

Neni 2

Komisioni do të bëjë verifikimin dhe vlerësimin e punëve të kryera si dhe do të rekomandoj zgjidhjen përfundimtare të pozicionit 3 në punët e zdruktarisë në kuadër të projektit të cekur.

Neni 3

Komisioni për punën e kryer në formë të shkruar informon Kryetarin e Komunës dhe Zyrën e Prokurimit.

Neni 4

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-020/04-0078937/21
Podujevë,
10 shtator 2021



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës, jep:

AUTORIZIM

I.

znj. Ardiana Dibrani, zyrtare për hipoteka në kuadër të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, autorizohet për nënshkrimin e certifikatave të pronës pas përpunimit dhe përfundimit të lëndëve dhe të deponojë nënshkrimin me qëllim të vulosjes së tyre.

Nënshkrimi i të autorizuarës

A. Dibrani

II.

Autorizimi jepet për kohë të pacaktuar dhe vlen deri në revokimin apo plotësim ndryshimin e tij.

U dërgohet:

-Të autorizuarës

-Arkivës

Nr.02-020/05-0085524/21
Podujevë, 28 shtator 2021



Kryetari i Komunës
Shqipëtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 13, 17 shkronjat k) l) dhe nenit 58 shkronja g) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 12 të Ligjit 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit, nenit 5 të Udhëzimit Administrativ 22/2010 për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta të banimit, neneve 14, 16, 19 paragrafët 1.11; 1.12 dhe nenit 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01/0050862/18, dhe sipas Shkresës së Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës nr.02-1804-2/21 e datës 08.06.2021, e përcjellë përmes Ministrisë së Pushteti Lokal - Shkresa nr.020-396/10 të datës 10.06.2021, Kryetari i Komunës së Podujevës, nxjerrë këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN DHE PËRZGJEDHJEN E FAMILJEVE PËR FITUESE NGA PROGRAMET E VEÇANTA TË BANIMIT

Neni 1

Për vlerësimin dhe përzgjedhjen e familjeve që konkurrojnë për të përfituar nga programet e veçanta të banimit në Komunën e Podujevës, formohet komisioni në këtë përbërje;

1. **Arbresha Bashota**, nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, kryesues/e
2. **Makfirete Zeka**, nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, anëtare
3. **Ardonis Jusufi**, nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, anëtar
4. **Mirsime Haxhiu**, nga Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, anëtare
5. **Veton Aliu**, nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, anëtar

Neni 2

Komisioni sipas nenit 1 të këtij vendimi, përveç punëve dhe detyrave që parashihen me Ligjin për financimin e programeve të veçanta të banimit dhe aktet tjera ligjor dhe nënligjore përkatëse që ndërlidhen me këtë fushëveprimtari, bënë vlerësimin me pikë sipas kriterëve të përcaktuara në shtojcën nr.1 të Udhëzimit Administrativ (MMPH) për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit dhe bënë vlerësimin në terren të gjendjes së banimit të familjeve dhe verifikimin e të dhënave të kërkuarve në terren brenda afateve të përcaktuara.

Neni 3

Komisioni ngritët për kohëzgjatje të pacaktuar, dhe i njëjti mund të plotësohet, ndryshohet apo shfuqizohet me vendim nga Kryetari i Komunës.

Neni 4

Për punën e kryer, komisioni në periudha të caktuara paraqet raport në formë të shkruar dhe të njëjtin ia dorëzon Kryetarit të Komunës përmes Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet; Anëtarëve të Komisionit, Drejtorive përkatëse, arkivës

Nr.prot.02-020/04-0086369/21
Podujevë, 30 shtator 2021

